



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më 26.09.2025

**MBLEDHJA Nr. 38,
Datë 30.09.2025, ora 10:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 30.09.2025, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 38 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi disa ndryshime në vendimmarrjet e Bordit të ERE-s, lidhur me plotësimin e kushteve nga subjektet e licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 296, datë 30.12.2024 “Mbi licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaiik “Blue 2”, me kapacitet të instaluar 50 MW.
3. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 29, datë 03.02.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “MER ENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.
4. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.01.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 100 MW”.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “GSA ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “GSA ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “VIVID POWER” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “VIVID POWER” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

9. Mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN VALUE” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
10. Mbi kërkesën e shoqërisë “REYTECH TRADING” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI